



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 124/7 Prot

Tiranë, më 07.05.2019

V E N D I M

Nr. 44, datë 07.05.2019

***“Mbi verifikimin e zbatimit të ligjshmërisë në zhvillimin e procedimit disiplinor ndaj
nëpunësit *****”***

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në përfundim të verifikimit të informacionit të marrë nga kërkesa e nëpunësit *****,

VËREJ SE:

Nëpërmjet një kërkesë të regjistruar pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me nr. 124/2 prot., datë 12.2.2019, nëpunësi ***** ka parashtruar pretendimet e tij për mungesë të shkaqeve të ligjshme, në zhvillimin e një ecurie disiplinore në ngarkim të tij, në përfundim të të cilës Komisioni i Disiplinës ka marrë masën disiplinore “Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri 3 (tre) muaj, përmospërbushje të detyrave”.

Nga tërësia e dokumentacionit të administruar, konstatohet se punonjësi ***** është nëpunës civil, pranë Drejtorisë Rajonale të Mjedisit, Tiranë dhe kryen detyrën, “Specialist i lejeve mjedisore dhe VNM-ve”, prandaj verifikimi i pretendimeve të ngritura për mosrespektim të të drejtave të nëpunësit civil, përfshihet në juridiksionin dhe kompetencën e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

Mosmarrëveshja objekt shqyrtimi, ka filluar në momentin kur eprori direkt, pasi ka vlerësuar se disa veprime të nëpunësit në fjalë, vinin në kundërshtim me përbushjen e rregullt të detyrës, ka vendosur fillimin e ecurisë disiplinore dhe për këtë, me shkresën

nr.425 prot., datë 23.1.2019, “Mbi fillimin e ecurisë disiplinore”, ka informuar nëpunësin ***** për fillimin e ecurisë disiplinore në ngarkim të tij.

Në përmbajtje të kësaj shkrese të eprorit direkt, është parashtruar fakti se në datën 16.1.2019, nëpunësi në fjalëka refuzuar të nënshkruajëakt miratimet/refuzimet për vendimmarrjet e komisionit nr. 2, datë 11.1.2019, për leje mjedisore me pretendimin se para nënshkrimit, kishte nevojë për të rishqyrtuar dokumentacionin e paraqitur nga subjektet, duke u bërë shkak për vonesa të pajustificuara në veprimtarinë e institucionit.

Këtë veprim të tij, eprori direkt e ka konsideruar moskryerje të detyrës funksionale, pasi referuar urdhërave të brendshëm mbi të cilat funksionon institucioni, për çdo aplikim nga subjektet për leje të tipit C, para se të kalojnë për shqyrim në komisionin vendimmarrës, specialistët (një prej të cilëve është dhe nëpunësi në fjalë) kanë për detyrë të kenë studiuar paraprakisht gjithë dokumentacionin që do të shqyrtohet në mbledhjen e radhës dhe duhet të jenë gati t’i prezantojnë Drejtorit të DRM, përmbajtjen e aplikimit dhe përshkrimin e dokumentacionit të paraqitur prej subjektit që kërkon leje mjedisore.

Shkeljen disiplinore, eprori direkt e ka cilësuar si, “mospërmbushje e detyrave”, e cila, në kuptim të nenit 57, pika 3, shkronja “a”, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, klasifikohet si shkelje e rëndë disiplinore dhe për këtë arsye, në bazë të pikës 2 të nenit 59 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, i ka kërkuar Drejtorit të Përgjithshëm të AKM, ngritjen e Komisionit të Disiplinës për shqyrtimin e shkeljes së kryer.

Mbi këtë bazë, Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, me Urdhrin nr.10, datë 23.1.2019, “Për ngritjen e Komisionit Disiplinor”, ka ngritur Komisionin Disiplinor, përbërja e të cilit (Drejtori i Përgjithshëm i AKM, në cilësinë e nëpunësit më të lartë civil të institucionit (kryetar i komisionit); Drejtori i Drejtorisë së Informacionit dhe Statistikave, i cili kryen detyrat e Drejtorit të DRM, (i komanduar në këtë detyrë me Urdhërin nr. 121, datë 19.6.2018, të Drejtorit të Përgjithshëm të AKM), në cilësinë e eprorit direkt (anëtar); Drejtore e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, si përfaqësues i njësisë së burimeve njerëzore (anëtar); Përgjegjëse e Shërbimeve, si nëpunësi më i vjetër civil i institucionit (anëtar), si dhe një përfaqësues i Departamentit të Administratës Publike) rezulton në përputhje me pikën 2, Kreu I, “Organet disiplinore”, të Vendimit nr. 115, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil”, të ndryshuar.

Komisioni Disiplinor, me marrjen e kërkesës për shqyrtimin e ecurisë disiplinore, me aktin nr. 426 prot., datë 23.1.2019, ka njoftuar nëpunësin, të cilit i atribuohet shkelja, duke treguar kujdesin e duhur për t’i garantuar nëpunësittë drejtat që parashikohen në pikën 7, të

nenit 59, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, të tilla si e drejta për t’u njoftuar lidhur me fillimin e procedimit, për t’u informuar lidhur me shkeljen faktike të pretenduar dhe provat për kryerjen e saj, e drejta për t’u dëgjuar, për të paraqitur prova, për mbrojtje juridike, e drejta për t’u asistuar nga një avokat apo një përfaqësues ligjor, etj.

Seanca dëgjimore për të shqyrtuar shkeljen e pretenduar ndaj nëpunësit në fjalë, është zhvilluar në datën 29.1.2019 (pas një shtyrjenë datën 28.01.2019), në ambientet e institucionit.

Në përfundim të shqyrtimit të kësaj ecurie disiplinore, duke mbajtur parasysh edhe njëmasë të mëparshme disiplinore, “Vërejtje”, që ishte e pa shlyer, Komisioni i Disiplinës me vendimin nr. 19, datë 29.1.2019, ka vendosur marrjen e masës disiplinore, “Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë, për një periudhë deri 3 (tre) muaj”, me motivacionin, “mospërmbushja e detyrave”.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të kësaj ecurie disiplinore, konstatohet se relacioni që eprori direkt, ka paraqitur përpara Komisionit Disiplinor, me anë të të cilit janë përshkruar shkeljet e pretenduara të kryera prej nëpunësit dhe vlerësimi e tij për këto shkelje, nuk është shoqëruar me dokumentacion shkresor apo prova të tjera, që të vërtetojnë këto pretendime. Organi disiplinor, ka marrë të mirëqena parashtrimet e eprorit direkt dhe në një kohë që gjendej para mohimit të nëpunësit të proceduar, nuk ka kryer hetim të plotë e të paanshëm, me anë të të cilit të mblidhte dokumenta shkresore apo materiale të tjera provuese, të cilat të vërtetonin në mënyrë bindëse faktin e vonesës së nënshkrimit të akteve që ka prodhuar komisioni i datës 11.1.2019, apo pasojat shumë të rënda që i ka sjellë institucionit ky veprim i nëpunësit.

Nga përmbajtja e pjesës arsyetuese të vendimit, konstatohet se Komisioni Disiplinor në këtë rast, është mjaftuar vetëm me dëshminë e punonjëses së arkivit të Drejtorisë Rajonale të Mjedisit (I. Sina), e cila ka pohuar se nëpunësi *****, lejet e mjedisit i ka firmosur me vonesë dhe jo qënë momentin e parë që i janë paraqitur, me pretendimin se do të shihte dhe një herë dokumentacionin e paraqitur nga subjektet, thënie të cilat nuk janë shoqëruar me shënime, fakte apo prova që të vërtetonin përse është krijuar kjo vonesë, sa ka qënë vonesa, kur janë nënshkruar aktet apo çfarë pasojash kanë ardhur ose mund të vinin, nga ky mosveprim apo veprim i vonuar.

Në bazë të nenit 82, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili përcakton se, “Në procedurat administrative të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë...”, rezulton që pala që ka pretenduar për shkeljen disiplinore, nuk e ka përmbushur këtë detyrim. Nga ana tjetër Komisioni Disiplinor, ka përmbyllur procedimin pa respektuar kërkesat e pikës 14, të Vendimit nr. 115, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për

përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil”, sipas të cilës organi disiplinor vlerëson të gjitha rrethanat e ngjarjes që janë të nevojshme për marrjen e vendimit, si dhe mund të përdorë çdo mjet për të mbledhur prova, në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative. Pra, masa disiplinore në këtë rast është marrë pa patur prova dhe pa vlerësuar faktet dhe rrethanat e pretenduara si shkelje disiplinore.

Nisur nga gjithë sa u thanë më sipër, në kushtet kur Komisioni Disiplinor i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, ka marrë një masë disiplinore të pa mbështetur në prova dhe fakte konkrete, arrihet nëpërfundimse të gjitha aktet që materializojnë veprimet e kryera për marrjen e masës disiplinore, ndonëse të kryera në respektim të procedurës së parashikuar nga legjislacioni i shërbimit civil, kanë elemente të dukshëm paligjshmërie, pasi jemi para ushtrimit të diskrecionit në mënyrë jo të ligjshme, gjë e cila në bazë të pikës “dh” të nenit 109, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, dhe pikës 1, të nenit 114, të këtij ligji, përbën shkak anulimin diskrecionar të këtij akti të paligjshëm.

Për rregullimin e gjendjes së ligjshmërisë, organi publik që ka nxjerrë aktin, në këtë rast Komisioni i Disiplinës, në bazë të pikës 1, të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, duhet të anulojë Vendimin e tij nr.19, datë 29.1.2019, për dhënien e masës disiplinore, “Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri 3 (tre) muaj”, nëpunësit *****, e shoqëruar kjo me anulimin e gjithë akteve të tjera administrative që kanë dalë në zbatim të vendimit të mësipërm.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në ligjin nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe në nenet 16, 34 dhe 35, të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA

1. Njësia e Burimeve Njerëzore të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, të drejtojë procesin administrativ në përmbajtje të të cilit, Komisioni i Disiplinës, në bazë të pikës 1, të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të anulojë Vendimin nr.19, datë 29.1.2019, për dhënien e masës disiplinore, “Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri 3 (tre) muaj”, nëpunësit *****.

2. Njësia e Burimeve Njerëzore të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, të kujdeset për heqjen nga dosja e personelit të nëpunësit ***** , të aktit të mësipërm të dhënies së masës disiplinore dhe të fshihen shënimet e bëra në dosje.
3. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat 15 ditë, nga marrja e këtij vendimi.
4. Me kalimin e këtij afati, njësia përgjegjëse është e detyruar të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
5. Në rast të mos respektimit të këtij vendimi, përgjegjësia do të jetë personale e subjekteve, që nuk kanë kryer detyrimet e lëna në këtë vendim dhe në zbatim të përcaktimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjatimit të nëpunësit përgjegjës për moszbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.
6. Të njoftohet për këtë vendim Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Departamenti i Administratës Publike dhe nëpunësi *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha